




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
TIRANË



NR.RREGJ.THEM. 653  
DT. RREGJ. 05.04.2024

Nr. 5934/10 Vendimi  
Dt. Vendimi 12.04.2024

V E N D I M

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:  
**Alma KODRALIU – GJYQTARE**

Në dhomë këshillimi, sot më datë 12.04.2024 mori në shqyrtim kryesisht ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 5934/9 dt. 04. 04.2024, të kësaj gjykate, me palë, objekt dhe bazëe ligjore si më poshtë:

- KERKUESI:** Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), përfaqësuar nga Presidenti z. Fidel YLLI, dtl. 01.09.1962, i lindur në Tiranë, banues në Tiranë, Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, Tiranë.
- OBJEKTI:** Depozitimi dhe regjistrimi i Vendimit dt. 02.12.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të 29-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).
- BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Shqipërisë; Ligji Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", i ndryshuar; Ligjit Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", LIGJI Nr. 79/2017 Për SPORTIN.

V E R E N

Kërkuesi, ka paraqitur ne gjykate kerkesen per regjistrimin e vendimmarrjes se asamblese se Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2023. Në dispozitivin e vendimit është vendosur: “ 1. Pranimin e kerkeses. 2. Depozitimn ne regjistrat e OJF-ve te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, te vendimmarrjeve te mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2024. ...”

Pas dhënies së vendimit, kryesisht gjykata konstatoi gabimin e saj në shkrimin e datës së vendimmarrjes së Asamblesë së Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2023, datë e

cila gabimisht në dispozitivin e vendimit është vendosur" 02.12.2024". Po kështu edhe në pjesën arsyetuese, vendimit, në rrjeshtin e dytë është shënuar gabimisht e njëjta datë "02.12.2024".

Neni 312 K.Pr.Civile "Ndrejja e gabimeve" parashikon se: "Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit..."

Sa më sipër, pasur parasysh nenin 312 të K.Pr.Civile, kryesisht, me konstatimin e gabimit, gjykata vlerësoi ta rregullonte kryesisht gabimin material në vendimin e saj. Pasi u tërhoq fashikulli i vendimit që kërkohet të rregullohet u konstatua se bëhet fjalë për një gabim material në datën e mbledhjes së asamblesë së Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe në vend të datës 02.12.2023 është vendosur data 02.12.2024. Qartazi bëhet fjalë për një gabim material dhe rrjedhimisht ai duhet rregulluar.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126 dhe 312 të Kodit të Procedurës Civile,

### VENDOSI:

1. Ndrejjen kryesisht të gabimit material në vendimin nr. 5934/9, datë 04.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke e rregulluar atë në këtë mënyrë: në pjesën arsyetuese në rrjeshtin e dytë të vendimit, në vend të shënimit: "02.12.2024" rregullohet në "02.12.2023". Në dispozitivin e vendimit, pika e dytë e tij rregullohet si vijon: "Depozitimin në regjistrat e OJF-ve të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të vendimmarrjeve të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 02.12.2023."
1. Ky vendim i bashkëngjitet vendimit nr. 5934/9 datë 04.04.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe konsiderohet pjesë e tij.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i vecante brenda 5 ditëve nga nesërmja e njoftimit të vendimit.

Tiranë më datë 12.04.2024

Vendimi mori formë të prerë pasi  
nuk u ankimua më dt 30.04.2024  
Tiranë më dt 03.05.2024

K / SEKRETAR  
MIMOZA Tafa



GJYQTARE

Alma KODRALIU

